

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare e kolegjit, Enver Peci dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurës H. D., për shkak të dy veprave penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.2 të KPK, dhe dy veprave penale intoksimi i personit tjetër me narkotik ose substanca psikotropike nga neni 276 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurës paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Ppr.nr.460/2017 të datës 2.10.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1781/2017 të datës 9.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 24.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurës H.D., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Ppr.nr.460/2017 të datës 2.10.2017 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1781/2017 të datës 9.10.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin Ppr.nr.460/2017 e datës 2.10.2017, të pandehurës H.D., për shkak të dy veprave penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar.1.2 të KPK, dhe dy veprave penale intoksimi i personit tjetër me narkotik ose substanca psikotropike nga neni 276 të KPK, ia ka caktuar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e cila do të llogaritet nga data 30.9.2017 deri më 30.10.2017. Masa e paraburgimit është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 e 1.2.3 të KPPK-së.

Me aktvendimin Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1.nr.1781/2017 të datës 9.10.2017, është refuzuar si pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurës H.D., të paraqitura kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurës H.D., av. A.Sh., për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i

ndryshoi-anuloi aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ato të shkallës së dytë dhe masën e paraburgimit ta zëvendësojë me ndonjë masën tjetër alternative, apo çështjen ta kthej për rishqyrtim gjykatës së shkallës së parë.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi kryesisht thekson se nuk është bërë siç duhet cilësimi i veprës penale të vjedhjes së rëndë, se elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë janë kur vepra është kryer duke thyer, kaluar apo deportuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura, ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetesimit të pasurisë së luajtshme, ndërsa e pandehura nuk ka thyer, nuk ka deportuar me forcë në ndërtesat apo dhoma, andaj, vepra e cila mund t'i ngarkohet mund të jetë vjedhje e rëndomtë konform nenit 325 par.1 të KPK, dhe se shkeljet esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, mirëpo nuk i ka cekur se cilat shkelje janë ato.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.73/2017 e datës 20.10.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehures të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e çështjes, kryesisht nga kallëzimi penal nr.2017-GA-1570, raporti fillestar i incidentit nr.2017-GA-1570, procesverbalet mbi marrjen në pyetje të dëshmitarëve: V.B., A.K., D.P. dhe K.D., procesverbali mbi intervistimin e të pandehurës H.D., procesverbalet mbi marrjen në pyetje të viktimave B.B. dhe P.A., si dhe provat tjera të mbledhura gjerë më tani, rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se e pandehura është kryerëse e veprave penale për të cilën dyshohet, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënpar.1.1 të KPPK, për caktimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPK ngase me lëshimin e të pandehures në liri ekziston rreziku i ikjes, fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se veprat penale për të cilën dyshohet janë të një natyre të rëndë, e nëse e pandehura shpallet fajtores, parashihen dënime të larta, ashtu që e pandehura po të lihet në liri mund të jetë e paaritshme për organet e ndjekjes e një gjë e tillë është shumë e lehtë për të pasi që është shtetase e Republikës së Shqipërisë dhe se nuk ka vendbanim ose vendqëndrim të sigurt në

Republikën e Kosovës, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse po të gjendej e pandehura në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, mund të ndikoj që deklaratat e dëshmitarëve të ndryshohen në favor të saj pasi që të njëjtit ende nuk janë marrë në pyetje nga prokurori sepse hetimet ende janë në fazën fillestare, rrethana këto të cilat arsyetojnë drojën se me lënien e të pandehures në liri mund të vijë deri te pengimi i rrjedhës normale të procedurës penale.

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për caktimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së duke pasur parasysh peshën e veprave penale, rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale, karakteristikat personale të pandehurës, mënyra dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale, e sidomos fakti se e njëjta, duke vepruar kundërligjshëm ia merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit B.B., më datë 7.8.2017, dhe në të njëjtën mënyrë të dëmtuarit P.A., më datë 11.9.2017, duke iu hedhur substanca psikotropike pa dijenin e tyre të cilët më pastaj edhe kanë humbur vetëdijen, lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehures në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.291/2017, më datë 24.10.2017

B. profesionale,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa